

KONTRATE PER TRANSFERIMIN E AKSIONEVE

Sot me date 17.11.2020, lidhet kjo Kontrate per Transferimin e Aksioneve nga palët si me poshtë:

I. SHITESI:

"Pluton Investor" Shpk, me NIPT: K91417016M dhe adrese Rruga Ismail Qemali, Nr.32, kati 3, 1019, Njesia Bashkiake nr.5, Tirane, perfaqesuar nepermjet Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të kësaj Shoqërie me datë 16.11.2020, nga Z. Genti Laci.

(me poshte referuar si "**Shitesi**");

Dhe

II. BLERESI: Z. Valentin Çela, shtetas shqiptar, i biri i Tahir, lindur me 18.09.1996, ne Zhulat, Gjirokaster, mbajtës i pasaportes me nr. BF2184915 dhe nr. personal J60918064W, banues ne adresen Rruga Mahmut Xhelili, Ndërtesa 9, Hyrja 3, Ap. 05, Tiranë.

(me poshte referuar si "**Bleresi**");

DUKE QENE SE:

- a) Shitesi eshte aksioner ne shoqerine "Start-up Ventures" Sha, me NIPT: M01817018K dhe adrese: Rruga Ismail Qemali, Godina Nr. 32/1, kati 3, Njesia Bashkiake nr.5, Kodi Postar 1019 (me tej **Shoqeria**) dhe zotëron 100% te kapitalit aksionar. Kapitali aksionar i shoqërisë ndahet ne dy kategori aksionesh ku 60 (gjashtëdhjetë) aksione qe përfaqësojnë 60% te kapitalit te Shoqerise janë aksione te zakonshme me te drejte vote dhe 40 (dyzet) aksione te cilat përfaqësojnë 40% te kapitalit aksionar te Shoqerise janë aksione me përparësi pa te drejte vote.
- b) Shitesi deshiron te shesë 18 (tetëmbëdhjetë) aksione me përparësi pa te drejte vote te cilat përfaqësojnë 18% te kapitalit aksionar te Shoqerise (me tej "**Aksionet ne Shitje**"), ndersa Bleresi deshiron te bleje Aksionet ne Shitje sipas pjesëve te përcaktuara ne kete Kontrate dhe se bashku me te gjitha te drejtat dhe kufizimet qe këto Aksione ne Shitje përmbajnë ne përputhje me kategorinë te cilës i përkasin sipas Statutit te Shoqërisë.

Palet, mbi bazen e veprimeve te meposhtme, njohin dhe deklarojne si vijon:

1. OBJEKTI

1. Objekti i kesaj kontrate eshte shitja e Aksioneve ne Shitje te zoteruara nga Shitesi dhe blerja e tyre nga Bleresi sipas ndarjes përkatëse ne vijim:
 - 1.1 Shitesi i shtet dhe i transferon Z. Valentin Çela dhe ky i fundit pranon te blejë nga Shitesi, **18 (tetëmbëdhjete) aksione me përparësi pa te drejte vote**, pjese e Aksioneve ne Shitje, te cilat përfaqësojnë 18% te kapitalit aksionar te Shoqërisë;

- Pluton Investor Shpk, zotërues i 82 (tetëdhjetë e dy) aksioneve në total, te cilat përfaqësojnë 82 % te kapitalit aksionar te Shoqërisë, nga të cilat 60 (gjashtëdhjetë) aksione te zakonshme me të drejtë vote, te cilat përfaqësojnë 60 % te kapitalit aksionar te Shoqërisë (dhe 100% te te drejtave te votës ne Shoqëri) dhe 22 (njetzet e dy) aksione janë aksione me përparësi pa te drejte vote, te cilat përfaqësojnë 22 % te kapitalit aksionar te Shoqërisë.
- Z. Valentin Çela zotërues i 18 (tetëmbëdhjete) aksioneve, aksione me përparësi pa te drejte vote te cilat përfaqësojnë 18% te kapitalit aksionar te Shoqërisë;

2. ÇMIMI I SHITJES

Përkundrejt kalimit te pronësisë se Aksioneve ne Shitje sipas përcaktimeve me sipër, Blerësi paguan tek Shitësi, një çmim shitje prej 100 Leke (një qind leke) për çdo aksion, duke bere qe çmimi i shitjes ne total për te gjithë Aksionet ne Shitje te jete 1,800 Lek (nje mijë e teteqind Lekë) (me tej **Çmimi i Shitjes**) dhe përkatësisht :

- për aksionet e shitura tek Z. Valentin Cela çmimi i shitjes është 1,800 Lek (njëmijë e teteqind Lek).

3. TRANSFERIMI I AKSIONEVE

3.1. Me ane te kesaj kontrate, ne datën e nënshkrimit Shitesit i transferon Bleresit pronësinë mbi Aksionet ne Shitje sipas ndarjes se Nenit 1 me lart, me te gjitha te drejtat dhe kufizimet e tyre.

3.2 Blerësi duke nënshkruar ketë Kontrate dhe duke marre ne zotërim Aksionet ne Shitje sipas pjesëve përkatëse, është dakord dhe pranon te gjithë te drejtat, kufizimet, deklaratat, rregullat e procedurat e përcaktuara ne Statutin e Shoqërisë në të cilën ai bëhet aksionar dhe me te cilat deklararon se është njohur.

4. TE TJERA

4.1 Palet pranojne qe cdo deklarate, dorezim apo garanci e Paleve, sic parashikohet ne kete kontrate, eshte e vërtete dhe e sakte.


4.2 Shitesit dhe Bleresit autorizojne administratoren e Shoqërisë "Start-up Ventures" Sha dhe/ose persona te autorizuar prej saj qe te veproje per llogari te Shitesit dhe Bleresit per regjistrimin prane QRA-se, dhe QKB-se apo autoriteti tjetër, te aksioneve te transferuara.

4.3 Kjo marreveshje rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me ligjet e Republikës se Shqipërisë.

4.4 Palet bien dakort qe cdo mosmarreveshje qe lind ne lidhje me vlefshmerine, interpretimin apo zbatimin e kesaj kontrate te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Kjo Kontrate nenshkruhet nga Palet ne 2 (dy) kopje ne gjuhen shqipe;

Për Shitesin
Pluton Investor Sh.p.k


Z. Genti Laci



Blerësi

Z. Valentin Çela

